



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 14 , Datë 04 / 04 / 2017

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr.38 Regj., datë 06.04.2016, e M. M, kundër Drejtores së Spitalit Rajonal të Elbasanit, me pretendimin për diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

M. M ka qenë në marrëdhënie pune prej 5 vitesh, si sanitare, pranë Spitalit Rajonal Elbasan. Ankuesja shprehet se ka punuar me përkushtim dhe se ka zbatuar me përpikëmeri çdo urdhër të eprorit të saj. Ankuesja pretendon se i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës pa asnjë shkak, dhe pa marrë në konsideratë faktin se ajo është familjare dhe ka fëmijë për të rritur. Znj.M shpreh shqetësimin se e kanë larguar nga puna për mospërmbushje të kriterit të arsimit, ndërkohë që ajo është e vetmja sanitare me diplomë të arsimit të lartë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, **gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore,**

¹ Znj.Merko shprehet se është e diplomuar për mësuesi, në Universitetin “A.Xhuvani”, Elbasan.

predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.414/2 prot, datë 18.04.2016 u njoftua dhe ju kërkuar informacion Qendrës Spitalore “Xh. Kongoli”, Elbasan, lidhur me pretendimin e ngritur nga znj.M.
2. Duke mos patur një përgjigje zyrtare, me shkresën me nr.414/4 prot., datë 16.06.2016 iu dërgua një kujtesë për paraqitjen e informacionit të kërkuar, duke lënë një afat kohor deri më datë 30.06.2016.

Me shkresën me nr.1057/1 prot, datë 30.06.2016, Qendra Spitalore “Xh. Kongoli”, Elbasan, dërgon pranë Komisionerit argumentet e saj lidhur me rastin, si dhe paraqet dokumentacionin e kërkuar.

Nga ana e Spitalit Elbasan theksohet fakti se nisur nga parimi për të ndihmuar në sistemimin e ankueses pas largimit të saj nga puna, është biseduar me Drejtorinë e Zyrës Rajonale të Punësimit, Drejtorin për ndërmjetësim punësimi.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes nga Komisioneri.

A. Lidhur me pretendimin se është diskriminuar përmes largimit nga puna, duke iu nënshtruar një trajtimi të pafavorshëm në raport me punonjësit e tjerë.

Ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune si sanitare pranë Qendrës Spitalore “Xh.Kongoli”, prej rreth 5 vitesh, deri me datë 29.01.2016, datë kur i ndërpritën marrëdhëniet e punës².

Referuar akteve që Komisioneri ka administruar gjatë procesit të shqyrtimit të kësaj ankese, rezulton se:

- Me Urdhërin me nr.13, datë 15.01.2016 të Ministrit të Shëndetësisë³ është udhëzuar ristrukturimi i shërbimit spitalor në spitalet rajonale të vendit, duke përcaktuar dhe ngritjen e komisioneve për shqyrtimin e dosjeve të punonjësve të cilëve u suprimohet pozicioni i punës. Kriteret bazë, mbi të cilat komisioni i shqyrtimit të dosjeve të punonjësve do të bëjë vlerësimin në zbatim të strukturës së re të shërbimit spitalor rajonal, për pozicione të njëjta të cilat suprimohen, do të jenë:

² Referuar Urdhërit me nr.25, datë 29.01.2016.

³ Referuar shkresës me nr.244 prot., datë 15.01.2016, të Ministrit të Shëndetësisë.

- 1. Arsimimi.
- 2. Performanca në punë e punonjësve.
- 3. Disiplina në punë.

Në zbatim të këtij Urdhëri, Drejtoria e Spitalit Rajonal Elbasan, ka miratuar Strukturën Analitike për këtë qendër spitalore. Në këtë kuadër, në strukturën e re, në Sektorin e Shërbimeve Mjedisore, është përcaktuar një numër prej 65 sanitarësh në total (për administratën dhe shërbimet spitalore), duke mos bërë përcaktimin dhe ndarjen nëpër pavione specifike. Shpërndarja e sanitarëve nëpër pavione do të realizohet përmes një plani pune të përmuajshëm, sipas nevojave të organizimit të punës pranë kësaj qendre spitalore, dhe jo me emërim të përhershëm (apo të përkohshëm) të sanitarëve pranë një pavioni të veçantë.

Po t'i referohemi Strukturës së vjetër Analitike të Drejtorisë së Spitalit Elbasan⁴, numri i sanitarëve në total ishte 117, të specifikuar sipas pavioneve të veçanta, rast pas rasti.

Pra, sikundër shihet qartë nga krahasimi i këtyre dy strukturave, numri i sanitarëve të larguar nga puna është 52 në total.

Në zbatim të shkresës me nr.85 prot., datë 20.01.2016 të Drejtores së Spitalit Rajonal Elbasan, për zbatimin e shkresës me nr. 261 prot., datë 18.01.2016 të Ministrit të Shëndetësisë, është ngritur Komisioni shqyrtimin e dosjeve të punonjësve të cilëve u suprimohet pozicioni i punës. Ky Komision ka shqyrtuar dosjet e personelit, dhe në bazë të kriterëve të përcaktuara për vlerësimin e tyre ka bërë dhe vlerësimet rast pas rasti, sipas Tabelës së Pikaverazhit, ku:

1. Arsimi i mesëm kishte - 10 pikë dhe ai 8-vjeçar - 5 pikë.
2. Performanca: Shumë e mirë - 10 pikë. Mirë - 7 pikë. Mjaftueshëm - 5 pikë. Dobët - 2 pikë.
3. Disiplina: Shumë mirë – 10 pikë. Mirë – 7 pikë. Dobët – 2 pikë.

Bazuar në Strukturën e re Analitike të Spitalit Rajonal Elbasan, rezulton se nga 25 sanitarët që ishin të punësuar pranë Shërbimit të Pathologjisë, ku ishte dhe ankuesja, 14 prej tyre janë larguar. Nga krahasimi që ju bë dosjeve të tyre, nga ana e Komisionit, dosjeve të depozituara në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënive me Publikun, si dhe vlerësimit me pikë në Tabelën e Pikaverazhit, firmosur nga 8 anëtarët e Komisionit, rezultoi se, personat që kanë vijuar marrëdhëniet e punës me Spitalin Rajonal Elbasan, kanë pikë më të larta se sa ankuesja⁵. Kështu: R.Z; A.K; M.M; P.G; V.T; M.K; F.J janë vlerësuar me 30 pikë. SH.C është vlerësuar me 27 pikë dhe E.P; N.F; N.H, janë vlerësuar me nga 25 pikë.

Ndërsa, znj.Marsida Merko është vlerësuar me 24 pikë.(Arsimi 10 pikë, Performanca 7 pikë, Disiplina 7 pikë).

⁴ Referuar shkresës me nr.3525/1 prot., datë 30.07.2013, të Ministrit të Shëndetësisë.

Siç shihet, ankuesja ka marrë pikët maksimale sa i takon kriterit të arsimit dhe nuk është penalizuar nga ky fakt. (Arsimi i mesëm është ai që kishte pikët maksimale).

Janë mbajtur në punë sanitaret që janë vlerësuar me më shumë pikë nga ana e Komisionit të ngritur nga ana e Drejtorisë së Spitalit, (me nga 30, 27 dhe 25 pikë) dhe është larguar ankuesja, pasi në tavelën e pikaverazhit ajo rezultoi të ketë më pak pike (24 pikë).

Nga ana tjetër, rezultoi se të gjitha sanitaret që janë marrë si rast krahasues me ankuesen dhe aktualisht janë në punë, kanë plotësuar kriterin e arsimit të mesëm dhe të gjitha janë vlerësuar me pikët maksimale për këtë kriter.

Pra, arsimi nuk ka qenë një faktor i cili ka ndikuar në largimin e ankueses nga puna.

Për gjithë sa më sipër, nuk konstatohet se ka shkelje të nenit 7/1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, me veprim ose mosveprim të Spitali Rajonal Elbasan, që të krijojnë baza për mohimin e barazisë ose që ekspozon ankuesen ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Po ashtu, nuk konstatohet as shkelje e nenit 12, pika 1, e këtij Ligji, i cili parashikon se ndalohej diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim.

Nuk konstatohet që nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan të ketë diskriminim të ankueses, duke përfshirë këtu çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës, krahasuar me personat e tjerë që kanë qëndruar në punë.

B. Lidhur me shkakun e pretenduar nga ankuesja, si shkak të largimit të saj nga puna.

Për të vërtetuar se ndaj ankueses ka një sjellje diskriminuese nga ana e Spitalit Rajonal Elbasan, përmes largimit të saj nga puna, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”⁶ dhe trajtimin të pafavorshëm të saj.

Ankuesja pretendon se është diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore. Lidhur me këtë, ankuesja plotëson kriterin e kërkuar arsimor dhe për më tepër është me arsim të lartë. Lidhur me këtë ankuesja ka sjellë pranë Komisionerit një kopje të dokumentit “Diplomë e niveli të parë në mësuesi për ciklin parashkollor”.

Neni 1, i LMD-së e parashikon gjendjen arsimore, si shkak të mbrojtur prej tij.

⁶ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se ankuesja pretendon se është trajtuar ndryshe nga sanitaret e tjera që kanë qëndruar në punë, për shkak se vetëm ajo ka një diplomë të arsimit të lartë dhe të tjerat jo, nuk rezultoi i provuar fakti, pasi:

1. Kriteri i arsimit të vendosur ishte ai i mesëm = 10 pikë.
2. Nuk kërkohej arsim i lartë për pozicionin e sanitaresh, pavarësisht se ankuesja e plotëson.
3. Për më tepër ankuesja nuk kishte të depozituar në Dosjen e saj, pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore kopje të dokumentit Diplomë e arsimit të lartë. (Punëdhënësi nuk e kishte të dokumentuar këtë fakt).
4. Të gjitha sanitaret që vijuan të ishin në marrëdhënie pune e plotësonin kriterin e kërkuar njëjloj si ankuesja. Pra, të gjitha (përfshi edhe znj.M) janë vlerësuar me nga 10 pikë lidhur me kriterin e arsimit.

Në përfundim të procedurës së ndjekur për trajtimin e ankesës së znj.M, nuk u provua se ajo është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme krahasuar me sanitaret e tjera që janë aktualisht në punë, siç pretendoi ankuesja, për shkak të arsimit të saj, pasi ato janë vlerësuar nga Komisioni njëjloj, pra me pikët maksimale sa i takon arsimit (arsimi i kërkuar ishte ai i mesëm) dhe me më shumë pikë se ankuesja sa i takon kriterëve tjera dhe të vendosura dhe kjo ka shërbyer si vlerësim për qëndrimin e tyre në punë. Pra, për qëndrimin e tyre në punë, ka shërbyer vetëm vlerësimi i Komisionit të ngritur nga Drejtoria e këtij spitali (referuar Tabelës së Pikaverazhit). Pra, qëndrimi i Drejtorisë së Spitalit Rajonal Elbasan ka qenë i ligjshëm dhe jodiskriminues, i mbështetur në rezultatet e vlerësimit të Komisionit të ngritur për shqyrtimin e dosjeve, sipas Tabelës së Pikaverazhit.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, germa a) dhe, nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të gjendjes arsimore, të M. M, nga ana e Drejtores së Qendrës Spitalore “Xhafer Kongoli”, Elbasan.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në gjykatë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

Fusha: Punësim
Shkaku: Gjendja arsimore
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim